



Datë: 26.05.2025
Numër Protokolli: 3539/2025

A.nr.588/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.588/2025, të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi I.I, me përfaqësues të autorizuar avokat Faik Morina, kundër organit të punësimit:Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “ Kontestim konkursi ”, kundër organit të punësimit: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “kontestim konkursi ”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.3 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si bazuar** ankesa me numër A.nr.588/2025, e datë 03.04.2025, e parashtruar nga ankuesi I.I.
- II. Anulohet** Njoftimi i datës 11.03.2025 i Sektorit të Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, lidhur me rezultatin përfundimtar për procedurën e pranimit sipas konkursit me nr. Reference RN00016253 të datës 08.01.2025 për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Inspektime, ashtu që procedura e pranimit, kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e verifikimit paraprak.
- III. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjithë veprimet e nevojshme administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, ashtu siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.
- IV. Obligohet** Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.
- V.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil I.I, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 03.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2207/2025 të regjistruar nën shenjen A.nr. 588/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 11.03.2025, lidhur me shpalljen e rezultatit përfundimtarë për pozitën e punës “ Udhëheqës

i Sektorit për Inspektimë”, Divizioni i Inspektimit Fitosanitar (kufitar) në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa kjo e fundit me datë 11.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) si prova i administroi: Ankesën me numër protokolli 2207/2025 të datës 03.04.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 11.03.2025 i Sektorit të Personelit i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, lidhur me përzgjedhjen përfundimtarë të kandidatit suksesshëm; Konkursi me numër referencë RN00016253, i datës 08.01.2025; e mali i datës 04.03.2025, dërguar nga SIMBNJ, për I.I; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin I.I; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.04.2025, dërguar nga R.K, për M.Sh; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 588/2025, e datës 11.04.2025; Vendimi me numër protokolli 1564, e datës 22.05.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimi i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; Ndryshimi dhe plotësimi i Aktit të Emërimit, i datës 19.08.2016, për B.Z; Akt Emërimi me numër protokolli 3572, i datës 10.05.2018, për K.U; Akt Emërimi me numër protokolli 2997, i datës 08.07.2013, për D.Z; Vendimi me numër protokolli 295/2013, i datës 08.07.2013, i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i AUV-së; Akt Emërimi me numër protokolli 2998, i datës 08.07.2013, për E.D; Vendimi me numër protokolli 296/2013, i datës 08.07.2013, i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i AUV-së; Vendimi me numër protokolli 7724, i datës 25.11.2024, i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Lista e Aplikantëve; Njoftimi i datës 20.02.2025; Formulari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esësë së kandidatit nga Komisioni i Pranimi i datës 04.03.2025, sipas kodit CN5924; Formulari i Vlerësimit të Përgjithshëm të Esësë së kandidatit nga Komisioni i Pranimi i datës 04.03.2025, sipas kodit CN0356; Formulari i Vlerësimit Individual të anëtarit të Komisionit për kandidatit në Intervistë i datës 10.03.2025, për I.M, nga anëtari i komisionit B.Z; Formulari i Vlerësimit Individual të anëtarit të Komisionit për kandidatit në Intervistë i datës 10.03.2025, për I.M, nga anëtari i komisionit K.U; Formulari i Vlerësimit Individual të anëtarit të Komisionit për kandidatit në Intervistë i datës 10.03.2025, për I.M, nga anëtari i komisionit D.Z; Formulari i Vlerësimit Individual të anëtarit të Komisionit për kandidatit në Intervistë i datës 10.03.2025, për I.M, nga anëtari i komisionit E.D; Formulari i Vlerësimit Individual të anëtarit të Komisionit për kandidatit në Intervistë i datës 10.03.2025, për I.M, nga anëtari i komisionit M.Sh; Renditja përfundimtarë e kandidatëve e datës 10.03.2025; Aplikacioni i I.I, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 132, e datës 22.12.2003, për I.I, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatë për I.I; Certifikatë për I.I, e datës 10.06.2002; Certifikatë për I.I, e datës 20.06.2003; Kontrata e punës e datës 14.10.1999; Libreza e punës e datës 19.11.1986; Shkresë emërimi i datë 01.12.2000, për I.I; Shkresë emërimi i datë 01.001.2001, për I.I; Shkresë emërimi i datë 03.01.2002, për I.I; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.04.2010, për I.I; Akt Emërimi me numër protokolli 1148, i datës 23.03.2012, për I.I; Akt Emërimi me numër protokolli 1539, i datës 01.04.2014, për I.I; Vendimi me numër protokolli 1278, e datës 01.03.2024; Vendimi me numër protokolli 8405, i datës 29.11.2023; Vendimi me numër protokolli 1278, e datës 01.03.2024; Aplikacioni i I.M, me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë me numër protokolli 11095/03, e datës 12.05.2008, për I.M, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Diplomë me numër protokolli 17, e datës 04.11.2011, për I.M, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatë e datës 15-18, për I.M, e muajit nëntor të vitit 2022; Certifikatë e datës 01-04, për I.M, e muajit nëntor të vitit 2022; Certifikatë e datës 13-14,

e muajit nëntor e vitit 2023, për I.M; Certifikatë e datës 9-15, e muajit shtator e vitit 2018, për I.M; Certifikatë e datës 13-17, e muajit qershor e vitit 2016, për I.M; Certifikatë e datës 27.02.204, deri me datën 01.03.2025, për I.M; Certifikatë e datës 10.01.2014, për I.M; Akt emërimi me numër protokolli 2877, i datës 08.07.2013, për I.M; Akt emërimi me numër protokolli 3608, i datës 07.07.2014, për I.M; Vendimi me numër protokolli 613, i datës 10.02.2015, i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i AUV-së; Vendimi me numër protokolli 4873, i datës 19.08.2020 i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i AUV-së; Vendimi me numër protokolli 209, i datës 15.01.2025, i nxjerr nga Z. Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Vendimi me numër protokolli 8423, i datës 16.12.2024, i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Vendimi me numër protokolli 2438, i datës 15.05.2024, i nxjerr nga u.d Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Vendimi me numër protokolli 8932, i datës 14.12.2023, i nxjerr nga u.d Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Vërtetim me numër protokolli 7284, i datës 18.11.2024, i nxjerr nga Zyrtarja e Personelit e AUV-së.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është pjesërisht e bazuar, **sepse:**

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur së Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datë 08.01.2025, ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00016253, për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Inspektimeve", numri i kërkuar një (1) pozitë, Drejtues i Ulët me afat aplikimi nga data 09.01.2025 deri me datë 07.02.2025.

Tutje në këtë procedurë sipas njoftimit të datës 20.02.2025 të Sektorit të Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, njëzetë e dy (22) kandidat kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se i kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit në mesin e tyre edhe ankuesi, ndërsa në renditje përfundimtarë të kandidatëve ankuesi rezulton, se është vlerësuar me zero (0) pikë, në testim me shkrim.

Në testin me shkrim kanë marr pjesë dymbëdhjetë (12) kandidatë mesin e tyre edhe ankuesit ndërsa vetëm dy kandidatet rezulton se e kanë kaluar testin me shkrim, ndërsa ankuesi edhe pse i është nënshtruar testit me shkrim rezulton se është vlerësuar me zero (0) pikë, për arsye që i njëjti në shenjë protestë nuk i është përgjigjur pyetjeve të testit, sepse sipas vet aplikuesit ishte i kjtartë së fituesi i kësaj pozitë në këtë testim me shkrim është (I.M) dhe së testimi me shkrim ishte vetëm një çështje formale procedurale e komisionit vlerësues dhe zgjedhor.

Tutje, Sektori i Personelit i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 11.03.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fituese, nga i cili njoftim rezulton se kandidati I.M, është vlerësuar me gjithsejtë 96, pikë si kandidati fitues.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00016253", për pozitën " Udhëheqës i Sektorit për Inspektime", numri i kërkuar një (1) pozitë, Drejtues i ulët, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë universiteti-Diplomë e arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor); **Përvoja e punës e kërkuara:** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Andaj Kolegji i Këshillit, lidhur me çështjen juridike iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- **Nenit 39 paragrafi 1:** *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.*

- **Nenit 44 :** *1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësia përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësia përgjegjëse, në SIMBNj-së, në ueb faqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.*

- **Nenit 45 paragrafi 1 dhe 2:** *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. 2.2. tre (3) nëpunës/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; një (1) nëpunës/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.*

Po ashtu për vendosje të drejtë dhe meritore, Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

- **Nenin 7 :** *1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.*

- **Nenin 8:** *Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.*

- **Nenit 22:** *Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunës civil nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.*

Referuar kuadrit ligjor si me lart Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidatit fitues si në vijim; I.M, të shpallur fitues dhe si rrjedhojë ka gjetur se i njëjti posedon Certifikatën me Nr. 11095/03 të datës 12.05.2008 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me të cilën dëshmohet se i njëjti ka përfunduar studimet themelore Bachelor në Mbrojtjen e Bimëve, diplomën me numër protokolli Nr.17, të datës 03.08.2011 me të cilën dëshmohet se i njëjti ka përfunduar studimet Master i Shkencave të Bujqësisë, me përvojë punë si në vijim, sipas Akt Emërimit me numër protokolli 2877, të datës 08.07.2013, në pozitën ‘‘ Inspektor fitosanitar’’, Akt Emërimit me numër protokolli 3608, të datës 07.07.2015, në pozitën ‘‘ Inspektor Fitosanitar’’, sipas vendimit me numër protokolli 613, të datës 10.02.2015, të nxjerr nga Kreyeshafi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, nga pozita Inspektor Fitosanitar’’, transferohet në pozitën Inspektor Fitosanitar kufitar, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas vendimit me numër protokolli 209, të datës 15.01.2025 të nxjerr nga z.d Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, nga pozita Inspektor Fitosanitar caktohet zëvendësues i pozitës Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar Kufitar, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas vendimit me numër protokolli 8932, të datës 14.12.2023 të nxjerr nga U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, nga pozita Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar Kufitar caktohet ushtrues i detyrës Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar Kufitar, sipas vendimit me numër protokolli 2438, të datës 15.05.2024 të nxjerr nga U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, i vazhdohet ushtrimin i detyrës Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar Kufitar, dhe sipas vendimit me numër protokolli 8423, të datës 16.12.2024 të nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, i vazhdohet ushtrimin i detyrës Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar Kufitar. Prandaj bazuar në konstatimet si me lartë Kolegji i Këshillit konstaton së Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në rastin e përfshirjes në listën e ngushtë të kandidati I.M dhe përzgjedhjes përfundimtare si kandidat i suksesshëm për Udhëheqës i Sektorit për Inspektime, sepse në rastin konkret kriteret e konkursit të shpallur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për Udhëheqës i Sektorit për Inspektime, ***kanë qenë që kandidatët të kenë Diplomë universiteti-Diplomë e arsimit të lartë të nivelit të parë, ndërsa në listën e ngushtë kanë përfshirë dhe me tej kanë përzgjedhur si kandidatin të suksesshëm I.M, i cili posedon vetëm Certifikatën me Nr. 11095/03 të datës 12.05.2008 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, e jo diplomë të kërkuar sipas pas pikës 3 të konkursit të shpallur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.***

Prandaj nisur nga fakti se kandidati I.M është përfshi në listën e ngushtë në mungesë të diplomës së fakultetit si kriter të konkursit dhe më tutje i njëjti kandidatë është përzgjedhur, Kolegji vendosi që këtë procedurë të rekrutimit ta kthej në fazën e verifikimit paraprak të aplikacioneve.

Përmbledhur si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.588/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit Faik Morina;
- Organit të punësimit: Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në AUV;
- Arkivit të KPMSHCK-së